

Shënime mbi pasqyrat financiare
Për fundvitin 31 Dhjetor 2019
(Të gjitha balancat janë në LEKE)

1. TE DHENA MBI SHOQERINE

“Meat Master“ SHPK është krijuar më 01/06/1995 dhe është rregjistruar në Q.K.R me NIPT – K06527025T.

Statusi juridik Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar.

Selia e entitetit ndodhet në Shkoder

Objekti i Veprimtarisë: Tregtim dhe prodhim të mishit dhe nenprodukteve të tij.

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet me:

Statutin e shoqërisë

Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët Shoqëritë Tregtare”,

Ligji Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, ndryshuar me Ligjin Nr. 9477, datë 09.02.2006,

Legjislacioni Fiskal,

Akte të tjera ligjore e nënligjore të shtetit Shqiptar.

Drejtimi realizohet nga:

Asambleja e Përgjithëshme, e cila perbehet nga dy ortakë Cesk Kimca me 69.45 % të pjeseve dhe Ardjan Kimca me 30.55% të pjeseve. Administratori i shoqërisë është Cesk Kimca.

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME TE KONTABILITETIT

2.1 Baza e përgatitjes së PF,

Kontabiliteti mbahet me Programin FINANCE 5/0 mbi bazën e parimeve dhe metodave që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar, si dhe të Standardeve Kontabël të shpallura nga Ministri i Financave me urdhërin Nr.4292, datë 15.06.2006 në zbatim të këtij ligji. Ato janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin dhe jo kur arkëtohen. Rregjistrimet kontabël janë kryer në mbështetje të dokumentave justifikuese, të vlerësuara përsa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet. Pasqyrat janë përgatitur në LEKE shqiptare, monedha kombëtare e Republikës së Shqipërisë. Të gjitha transaksionet në monedha të tjera janë konvertuar në LEKE.

2.1.1 Zbatimi Parimeve Kontabël

2.1.2 Parimi i kujdesit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kujdesit.

2.2 Zbatimi Parimeve Kontabël (vazhdon),

2.1.3 Parimi i vijimësisë së aktivitetit, Llogaritë vjetore janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë.

2.1.4 Llogaritja e saktë dhe periudha përkatëse, Të ardhurat dhe shpenzimet janë kontabilizuar në periudhën përkatëse raportuese.

2.1.5 Saktësia e çeljes, Mbyllja e vitit 2017 është mbartur saktë në çelje të vitit 2018.

2.1.6 Moskompesimi i aktivitetit dhe detyrimeve, nëse nuk egziston një e drejtë ligjore, është zbatuar korekt.

2.1.7 Informacioni i besueshëm dhe i plotë për të gjitha transaksionet apo ngjarjet e konsiderueshme, Sistemi kontabël i përdorur është i siguri.

2.1.8 Krahasueshmëria, Çdo post i bilancit dhe pasqyrës së rezultatit është paraqitur me shifra korresponduese.

MEAT MASTER
Vellezerit Kimca
SHKODER

2019

**Shënime mbi pasqyrat financiare
Për fundvitin 31 Dhjetor 2019
(Të gjitha balancat janë në LEKE)**

2.1.9 Parimi i sinqeritetit, Llogaritë janë transparente dhe të kuptueshme, me përshkrim të plotë, të qartë dhe të ndershëm të gjëndjes së shoqërisë.

2.2 Metodat e vlerësimit

Vlerësim është i njëjtë nga një periudhë në tjetrën. Nuk ka ndryshim në politikat kontabel.

2.2.1 Aktivet afatgjata materiale (AAGJM), janë vlerësuar me koston e amortizuar.

Aktivët amortizohen me norma fikale. Janë përdorur këto norma amortizimi:

| Aktivi | Normat e amortizimit të përdorura për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2017 |
|-------------------------|--|
| Ndertesat | 5% e vlerës së mbetur |
| Makineri e Pajisje | 20% e vlerës së mbetur |
| Kompjutera dhe programe | 25% e vlerës së mbetur |
| Mjete transporti | 20% e vlerës së mbetur |

2.2.2 Gjëndje Inventari, Në hyrje janë vlerësuar me koston dhe më pas me koston mesatare

2.2.3 Kërkesat për Arkëtim, njihen me vlerën për tu arketuar dhe në vijim me koston e amortizuar.

2.2.4 Detyrimet e tjera, njihen me vlerën për tu paguar dhe në vijim me koston e amortizuar.

2.2.5 Gjëndjet në valutë të huaj,

Asetet jo monetare vlerësohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet monetare gjëndje në fund vlerësohen me kursin zyrtar të publikuar nga Banka e Shqipërisë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje.

Kurset e këmbimit të përdorura për këmbimin e valutës në LEKE janë:

| Monedha | 31.12.2018 | 31.12.2017 | 31.12.2016 | 31.12.2015 | 31.12.2014 | 31.12.2013 |
|---------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| | LEKE/valute | LEKE/valute | LEKE/valute | LEKE/valute | LEKE/valute | LEKE/valute |
| USD | 107.82 | 111.1 | 128.17 | 125.79 | 115.23 | 101.86 |
| EUR | 123.42 | 132.95 | 135.23 | 137.28 | 140.14 | 140.2 |

2.4 Njohja e të ardhurave

E ardhura nga aktivitetet e zakonshme matet me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë, neto nga kthime dhe zbritje tregtare. Të ardhurat nga shërbimet njihen në momentin kur shërbimet ofrohen.

Administrator
Cesk Kimca

MEAT MASTER
Vellezerit KIMÇA
SHKODER - ALBANIA

